

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Një politikan mundet me votë, jo me vendime gjyqësore" - Avokati i Veliajt: Vendimi i sotëm ngre pikëpyetje serioze për shtetin e së drejtës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/nje-politikan-mundet-me-vote-jo-permes-lawfare-it-avokati-i-veliajt-vend-i586222
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:29:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f49d4ad3729bc8b486c539e3b1758096ea817c46b263a4672b120d31bb9ab4eb
TEKSTI	9c273218fe36cb6e8b80029d0de30a0d668e2a773ed7f940e8abcecff2604153
PAMJA	00d4ead60324de06aa76c2a4466b6f4d78c600b158f96e0bf9f081169b6a2ec6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9ef0eb5599fa7f2e0d281787e65c3523a713cb8d2ab787d3a5ca3e4764e4d739
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9ef0eb5599fa7f2e0d281787e65c3523a713cb8d2ab787d3a5ca3e4764e4d739>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e Europa nuk e di me çtare eshte "Nje politikan mundet me vote, jo me vendime gjyqesore" - Avokati i Veliajt: Vendimi i sotem ngre pikepyetje serioze per shtetin e se drejte fundit

“Një politikan mundet me votë, jo me vendime gjyqësore” - Avokati i Veliajt: Vendimi i sotëm ngre pikëpyetje serioze për shtetin e së drejtës



15 Shtator 2026, 12:23Kronika TEMA



Avokati mbrojtës i kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj, Plarent Ndreca, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të lënë në fuqi masën e sigurisë “arrest në burg”. Ndreca e cilëson vendimin “jashtëzakonisht shqetësues” dhe thotë se ai bie ndesh me efektin detyrues të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke paralajmëruar se mbrojtja do të përdorë çdo mjet juridik të parashikuar nga ligji dhe instrumentet ndërkombëtare.

Deklarata e plotë e avokatit Plarent Ndreca

Vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë përbën një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend. Duke lënë në fuqi një vendimarrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit.

Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit.

Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë. Prej 19 muajsh, qytetarët e Tiranës janë privuar nga kryetari që kanë zgjedhur. Z. Erion Veliaj prezumohet i pafajshëm dhe vazhdon të mbahet në paraburgim, ndonëse hetimi ka përfunduar prej një viti dhe çështja ndodhet në gjykim.

E gjithë kjo nuk është arsye për t'u dorëzuar, por për ta vijuar betejën. Mund ta izolojnë dhe t'i kufizojnë mundësinë për të folur, por nuk mund ta mundin politikisht nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Një politikan mundet me votë, përballë qytetarëve, dhe jo përmes “lawfare”-it.

Në do të përdorim çdo mjet juridik që parashikon Kushtetuta, ligji dhe instrumentet ndërkombëtare.

Shqipëria meriton një drejtësi të standardeve evropiane, e cila garanton të drejtat, respekton vendimet kushtetuese dhe mbron demokracinë, mjetin më të lartë që qytetarët kanë në dorë për të vendosur se kush i përfaqëson dhe kush e drejton vendin.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Operacion i AMP-së në Durrës, arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë](#)

12:05 Kronika

Shpërthim me lëndë plasëse në oborrin e një banese, çfarë ndodhi gjatë natës në Shijak

11:15 Kronika

[Kushtetuesja vuri në pikëpyetje proporcionalitetin e arrestit, Gjykata e Lartë lë në burg kryebashkiakun Erion Veliaj](#)

11:12 Kronika / 7 komente

Cënuan perimetrin e sigurisë në shkollë gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

10:55 Kronika / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.